FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

# VEPROL

## TABLETA TË VESHURA ME FILM
## 40 mg, 80 mg (Verapamil Klorhidrat)

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**

**1.** Çfarë është Veprol dhe përse përdoret
**2.** Përpara se të merrni Veprol
**3.** Si ta merrni Veprol
**4.** Efekte anësore të mundshme
**5.** Si ta ruani Veprol
**6.** Informacion i mëtejshëm


### 1. ÇFARË ËSHTË VEPROL DHE PËRSE PËRDORET
Veprol përmban si lëndë aktive verapamil klorhidrat.
Verapamili është një bllokues i kanaleve të kalçiumit. Mekanizmi i veprimit konsiston në frenimin e hyrjes së kalçiumit në qelizë. Qelizat kryesore ku vepron verapamili janë: qelizat e muskulaturës së lëmuar të enëve të gjakut, qelizat e miokardit, qelizat e nyjes atrioventrikulare dhe nyjes sinoatriale. Efekti kalçibllokues shprehet me dilatacion dhe veprim antispastik në arteriet koronare, në arteriet dhe arteriolat periferike. Verapamili shkakton zvogëlim të përçueshmërisë atrioventrikulare, zvogëlim të frekuencës kardiake dhe ulje të forcës tkurrëse në zemër.

**Veprol përdoret në trajtimin e:**
- aritmive supraventrikulare;
- angina pektoris;
- hipertensionit.

### 2. PËRPARA SE TË MERRNI VEPROL
**Mos merrni Veprol në qoftë se keni:**
- mbindjeshmëri ndaj verapamilit apo ndonjërit prej përbërësve të tjerë (eksipientëve) të Veprol;
- hipotension, bradikardi, shkallën e dytë ose të tretë të bllokut atrioventrikular, sindromë të sinusit të sëmurë, shok kardiogjen, bllok sinoatrial;
- të dhëna për insufiçiencë kardiake ose dëmtim të theksuar të funksionit të ventrikulit të majtë, madje edhe kur ai kontrollohet nga një terapi;
- flater atrial ose fibrilacion të shoqëruar me rrugë aksesore të përçimit (p.sh. sindromi Wolff-Parkinson-White);
- porfiri akute.

**Tregoni kujdes të veçantë me Veprol**
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Veprol.
Veprol duhet të përdoret me kujdes në shkallën e parë të bllokut atrioventrikular, fazën akute të infarktit të miokardit dhe në pacientët që marrin beta-bllokues (mund të përdoret vetëm në rastet kur funksioni i miokardit ruhet mirë).
Përdorimi i Veprol duhet të shmanget gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë, përveç rasteve kur përdorimi i tij është shumë i domosdoshëm.
Ndërprerja e menjëhershme e këtij bari mund të shoqërohet me përkeqësim të anginës.
Dozimi me Veprol duhet të reduktohet në pacientët me dëmtime hepatike.
Duhet të shmangni marrjen e Veprol në të njëjtën kohë me lëngun e grejpfrutit.

**Marrja e barnave të tjera**
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë, keni marrë së fundmi ose mund të merrni barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni duke u trajtuar me:
- anestezikë të përgjithshëm sepse fuqizojnë efektin hipotensiv të verapamilit;
- amiodaron, disopiramid ose flekainid, dronedaron (antiaritmikë);
- klaritromicin, eritromicin, rifampicin (antibiotikë);
- dabigatran eteksilat (antikoagulant);
- frenues të monoaminoksidazës (MAOI), buspiron, litium, lule basani, triciklikë (barna kundër depresionit, ankthit dhe psikozave);
- karbamazepin, fenitoin, primidon (antiepileptikë);
- atazanavir (antiviral);
- midazolam (hipnotik);
- barbiturate sepse ulin efektin e verapamilit;
- beta-bllokues sepse rrisin rrezikun për asistol, hipotension të rëndë dhe insufiçiencë kardiake;
- digoksinë (glikozid kardiak);
- kolkicinë (bar që përdoret për trajtimin e gutës), sepse verapamili mund të rrisë riskun për toksicitet nga kolkicina; shmangni përdorimin e njëkohshëm në insufiçiencën hepatike ose renale;
- eplerenon (diuretik);
- dutasterid (antagonist hormonal);
- ciklosporin, everolimus, sirolimus dhe takrolimus (imunosupresorë);
- ivabradinë sepse verapamili rrit përqëndrimin plazmatik të saj; shmangni përdorimin e njëkohshëm të tyre;
- simvastatin (bar që ul nivelin e kolesterolit në gjak);
- teofilinë (bar që përdoret në astmë).

**Marrja e Veprol me ushqim dhe pije**
Nuk duhet të konsumoni lëngun e grejpfrutit gjatë kohës që jeni duke marrë Veprol, sepse rritet përqëndrimi i verapamilit në gjak.
Nuk këshillohet konsumimi i alkoolit gjatë kohës që jeni duke marrë Veprol duke qenë se verapamili rrit përqëndrimin e alkoolit në gjak.

**Shtatzënia**
Nëse jeni shtatzënë, mendoni se mund të jeni shtatzënë ose planifikoni të mbeteni, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për këshilla përpara se të merrni këtë bar.
Përdorimi i Veprol gjatë shtatzënisë mund të ulë fluksin e gjakut në mitër duke shkaktuar hipoksi të fetusit. Ai duhet të shmanget gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë, përveç rasteve kur përdorimi i tij është shumë i domosdoshëm. Veprol gjithashtu frenon lindjen.

**Ushqimi me gji**
Nëse ushqeni fëmijën me gji, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për këshilla përpara se të merrni këtë bar.
Disa studime kanë treguar se sasia e verapamilit që kalon në qumështin e gjirit është shumë e vogël për të qenë e dëmshme. Megjithatë, verapamili nuk rekomandohet të përdoret gjatë ushqimit me gji, përveç rasteve kur mjeku e konsideron të nevojshëm përdorimin e tij.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**
Veprol mund të shkaktojë marrje mendsh, lodhje, përgjumje dhe çrregullime të ekuilibrit, duke ndikuar në këtë mënyrë aftësinë për të drejtuar automjetin ose përdorur makineritë. Rekomandohet të shmanget përdorimi i Veprol gjatë drejtimit të automjetit ose përdorimit të makinerive, veçanërisht kur keni konsumuar alkool, sepse verapamili rrit nivelin e alkoolit në gjak duke theksuar efektet e tij.

### 3. SI TA MERRNI VEPROL
Gjithmonë Veprol merret ekzaktësisht siç ju thotë mjeku juaj. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni i sigurt.

**Të rriturit**
Aritmitë supraventrikulare: 40 – 120 mg, 3 herë në ditë.
Angina pektoris: 80 – 120 mg, 3 herë në ditë.
Hipertension: 240 – 480 mg në ditë, në 2 – 3 doza të ndara.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Veprol**
Në qoftë se keni marrë më shumë Veprol se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshilla për veprimet që duhet të ndërmerren.
Mbidozimi me verapamil shkakton simptoma të cilat janë kryesisht zgjatja e efekteve anësore të zakonshme, të tilla si: hipotension, bradikardi, bllok atrioventrikular ose asistol dhe raste fatale.
Trajtimi: Të gjitha mbidozimet nga verapamili duhet të konsiderohen serioze si dhe pacientët duhet të jenë nën vëzhgim për të paktën 48 orë në ambjentet spitalore. Rekomandohet lavazhi i stomakut dhe administrimi intravenoz i lëngjeve. Verapamili nuk mund të eliminohet me dializë.

**Në qoftë se keni harruar të merrni Veprol**
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

**Në qoftë se ndërprisni marrjen e Veprol**
Ndërprerja e menjëhershme e verapamilit mund të shoqërohet me përkeqësim të anginës.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjitha barnat e tjera, verapamili mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Mjekimi me verapamil në përgjithësi tolerohet mirë, por efektet anësore të lidhura me efektet farmakologjike të tij në përçimin kardiak, mund të rriten dhe mund të shprehen më shumë në pacientët me dëmtim të mëparshëm të miokardit ose kardiomiopati hipertrofike.
Efektet anësore në zemër përfshijnë: bradikardi, bllok atrioventrikular, përkeqësim të insufiçiencës kardiake dhe asistol kalimtare.
Këto efekte janë më të zakoshme gjatë terapisë parenterale sesa terapisë orale.
Efekti anësor jo-kardiak më i mundshëm është konstipacioni. Mund të shfaqen nauze, të cilat janë raportuar më rrallë.
Efekte të tjera anësore përfshijnë: hipotension, marrje mendsh, afshe, dhimbje koke, lodhje, dispne dhe edemë periferike.
Gjithashtu janë raportuar reaksione në lëkurë, disa raste të funksionimit jonormal të mëlçisë dhe hepatotoksicitet, si dhe hiperplazi gingivale. Gjinekomastia është raportuar rrallë.
Lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj nëse ju shfaqen këto efekte anësore ose çdo efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues.

### 5. SI TA RUANI VEPROL
Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Veprol pas datës së skadencës të shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal.

### 6. INFORMACION I MËTEJSHËM
**Çfarë përmban Veprol – Tableta të veshura me film 40 mg**
Lënda vepruese është verapamil klorhidrat.
Çdo tabletë e veshur me film përmban 40 mg verapamil klorhidrat.

**Përbërës të tjerë:** celulozë mikrokristalore, kroskarmelozë natriumi, amidon i prexhelatinizuar, dioksid silici koloidal, stearat magnezi dhe Opadry II rozë.

**Çfarë përmban Veprol – Tableta të veshura me film 80 mg**
Lënda vepruese është verapamil klorhidrat.
Çdo tabletë e veshur me film përmban 80 mg verapamil klorhidrat.

**Përbërës të tjerë:** celulozë mikrokristalore, kroskarmelozë natriumi, amidon i prexhelatinizuar, dioksid silici koloidal, stearat magnezi dhe Opadry II i kuq.

**Përmbajtja e paketimit**
Veprol – Tableta të veshura me film 40 mg
Kuti me 30 tableta.

Veprol – Tableta të veshura me film 80 mg
Kuti me 30 tableta.

**Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:**

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Nuk duhet ta përdorni gjatë shtatzënisë.

Përmbajtja. Kujdes. Forma e tabletës.

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAH) dhe prodhuesi:**


**PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel./Fax: 00355 4 23 62 800
Tiranë - Albania


**Ky fletëudhëzues u formulua në Janar 2015.**